

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	YouTube sjell mjete të reja me AI: Do të ndihmojnë krijuesit, jo t'i zëvendësojnë - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/youtube-sjell-mjete-te-reja-me-ai-do-te-ndihmojne-krijuesit-jo-ti-ze-vendesojne/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 22:34:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 22:31:24 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4a801e81e6c770cf4d1754efc4ff4779abc7774260e4a39ed0250d2f258e8ba7
TEKSTI	7c70bf4b72bc620a2e2924220a46e016d7889998c2c38d7bc3c9ecd3792d4cec
PAMJA	eef8b42c2f13ea3bed2b9fb7025c83cc6f45d42615a1c6a0f80912f45131b49e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	31809edae2efa2a58ad724165c5805aa2628e4dd44839366be2efaf8dc4e917e
E MËPARSHMJA	c84602940d1a360e3eb664727f8b9c6caf63e6cfbbd39be6e805e5095600e4e0
RRËNJA MERKLE	5b26aa313aa3ddde651ac47a494680111374b043820c87ae8b5a84ef9fd6c5c0
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/31809edae2efa2a58ad724165c5805aa2628e4dd44839366be2efaf8dc4e917e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Vlora Hyseni Benjamin Netanyahu Donald Trump SHBA Franca

BOTA | TEKNOLOGJI

YouTube sjell mjete të reja me AI: Do të ndihmojnë krijuesit, jo t'i zëvendësojnë

25 Shtator 2026 | 00:31

YouTube ka prezantuar një seri funksionesh të reja me inteligjencë artificiale, duke theksuar se teknologjia synon të lehtësojë punën e krijuesve dhe jo t'i zëvendësojë ata.

Në eventin vjetor "Made on YouTube" në Nju Jork, kompania prezantoi mjete të reja për editim, moderim, përkthim dhe monetizim, shumë prej të cilave do të integrohen te YouTube Shorts.

Një nga risitë kryesore është një asistent bisedor për editimin, i ndërtuar me teknologjinë Gemini të Google. Ai pritet të integrohet në YouTube Shorts dhe në aplikacionin YouTube Create në fillim të vitit 2027, duke ndihmuar krijuesit gjatë procesit të prodhimit.

YouTube po teston gjithashtu moderim të personalizuar me AI për komentet dhe po zgjeron mjetin për zbulimin e përdorimit të paautorizuar të fytyrës së krijuesve në video të gjeneruara me AI. Në të ardhmen, mbrojtja pritet të përfshijë edhe zërin.

Një tjetër zhvillim lidhet me transmetimet live. Në fillim të vitit 2027, YouTube synon të sjellë dublim automatik në kohë reale për YouTube Live, duke përdorur AI për përkthimin e përmbajtjes në gjuhë të tjera.

Sipas kompanisë, mbi 40% e kohës së shikimit të transmetimeve live vjen nga audienca ndërkombëtare, ndaj përkthimi automatik mund t'i ndihmojë krijuesit të arrijnë publik më të gjerë.

YouTube po zgjeron gjithashtu shërbimin Shopping dhe programet e affiliate marketing, ndërsa një funksion i ri, "Ask YouTube", do t'u lejojë përdoruesve të kërkojnë me AI rekomandime produktesh nga videot e krijuesve.

Një nga risitë kryesore është zgjerimi i testimit A/B. Deri tani krijuesit mund të krahasonin tituj dhe thumbnail-e të ndryshme, ndërsa tani YouTube po e shtrin testimin edhe te versione të ndryshme të së njëjtës video për të parë cili variant funksionon më mirë me audiencën.

Platforma po prezanton gjithashtu thumbnail-e dinamike, të cilat mund të ndryshojnë automatikisht sipas segmentit të audiencës, me synimin për të rritur klikimet dhe shtrirjen.

Në podcast, platforma po punon për lista të personalizuara sipas preferencave të dëgjuesit, ndërsa "Custom Feeds" do të krijojë faqe të plota rekomandimesh bazuar në kërkesat e

LAJMI I FUNDIT

00:16 **AI rrit kostot e sigurimeve shëndetësore. Kompanitë po analizojnë raportet mjekësore Inteligjencë Artificiale**

22:27 **Deputeti i PD zbulon letrën që i ka çuar ish-kryetares së SHISH, Vlora Hysenit**

22:23 **Mamdani u përgjigjet akuzave të Netanyahu të bëra në fjalimin e tij në OKB**

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN **"Vidh edhe ti", debat mes Kokës dhe Manjanit: Pse e bën personale?**

22:03 **E rëndë në Itali, 51-vjeçari shqiptar bie në gropën e ashensorit gjatë punës! Humb jetën**

21:53 **Senati amerikan hedh poshtë rezolutën që kufizon fuqitë e Trumpit në luftën kundër Iranit**

TESTIM

përdoruesve.

YouTube Music do të marrë gjithashtu funksionin “Ask Music”, që synon të krijojë përvoja muzikore të personalizuar përmes AI.

Një tjetër risi është “Shorts Series”, që do t’u lejojë krijuesve të organizojnë video të shkurtra në seri të njëpasnjëshme, duke u mbështetur te rritja e formateve të tipit mikrodramë në platformë.

Drejtuesit e YouTube theksuan se, pavarësisht zgjerimit të AI, teknologjia nuk mund të zëvendësojë zërin, kreativitetin dhe lidhjen e krijuesit me audiencën.

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

BOTA
Mamdani u përgjigjet akuzave të Netanyahu të bëra në fjalimin e tij në OKB

Kryebashkiaku i Nju Jorkut, Zohran Mamdani, iu përgjigj fjalimit të kryeministrit izraelit Benjamin Netanyahu në OKB, i cili përfshinte akuza për antisemitizëm dhe shtrembërim të...

22:23 | 24/09/2026

BOTA
Senati amerikan hedh poshtë rezolutën që kufizon fuqitë e Trumpit në luftën kundër Iranit

Senati i SHBA-së hodhi poshtë me një diferencë të ngushtë votash të enjten një rezolutë të udhëhequr nga demokratët që synonte të ndalonte luftën kundër...

21:53 | 24/09/2026

BOTA
Netanyahu sulmon ashpër kryebashkiakun e New York-ut: Turp të të vijë që shtrembëron faktet

Në një grindje të vazhdueshme publike, kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu sulmoi kryetarin e bashkisë së Nju Jorkut, Zohran Mamdani, duke e akuzuar atë për antisemitizëm...

21:07 | 24/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara Punësimi

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni

Follow Euronews on all platforms: